

## **Aftësimi në Media e Informacion: sfida e bibliotekave sot**

**Dr. Etleva Domi**

Aftësimi në Media e Informacion është një temë, që prej kohësh është bërë kryefjala e takimeve, tryezave të rrumbullakëta, konferencave, duke përfshirë një numër gjithnjë e më të madh njerëzish nga gjithë kontinentet dhe horizontet kulturore, si: bibliotekarë, staf akademik, specialistë të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, përfaqësues të medias së shkruar dhe elektronike, dhe jo vetëm, që po diskutohet dendur si në mjedise shkencore, ashtu edhe mediatike, duke u bërë “fjalë kyç” e manifesteve, deklaratave të shumta, si ajo e Pragës, Aleksandrisë, Parisit, Lionit, Havanës etj. apo e nismave të organizatave profesionale botërore, duke përbërë edhe sfidën e këtij fillimshekulli. Për më tepër, tema po merr vlerë të veçantë sidomos në situatën aktuale të pandemisë COVID-19, që ka mbërthyer mbarë botën, sfidë me të cilën po përballen të gjithë sot, përfshirë edhe sistemin bibliotekar, por tanimë duke e parë në një këndvështrim të ri.

### *Strategjia e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë*

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë si një ndër pionieret e zbatimit të Aftësimin në Media e Informacion, luan edhe sot rolin drejtues në vend. Hapat e para u hodhën me disa projekte pilot në fund të vitit 2014 me studentë të degëve të ndryshme të disa fakulteteve, ku nëpërmjet organizimit të seminareve, ofroheshin njohuri për: përdorimin e burimeve të informacionit në bibliotekë/motorëve të kërkimit/katalogëve të digjitar; orientimin në shumëllojshmërinë e informacionit digjital; përzgjedhjen në burimet digjitale; kërkimin në web dhe në tekst etj., për të vijuar me ritme më të vullshme në vitet që ndoqën pas. Prej vitit 2015 programet e Aftësimin në Media dhe Informacion janë pjesë përbërëse e strategjisë së përgjithshme të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, me module teorike apo praktike, ku krahas punonjësve të sistemit kombëtar bibliotekar, përfshihen edhe grupmosha të ndryshme përdoruesish, si: fëmijë të grupmoshës 7-11 vjeç; nxënës të arsimit 9-vjeçar dhe të mesëm; studentë të nivelit Bachelor dhe Master.

Aftësimi në Media Informacion është futur tanimë, si në praktikën e përditshme të bibliotekave, ashtu edhe në programet e saj të formimit dhe kualifikimit bibliotekar (Shkollës Kombëtare të Bibliotekonomisë dhe Qendrës së Trajnimit Bibliotekar). Ndërkohë që kurrikulat mësimore dhe modulet aktuale synojnë orientimin në kërkimin shkencor apo bibliografik; përzgjedhjen e burimet digjitale; qasjen në bibliotekën digjitale/ katalogun elektronik/katalogët e digjitar/e-bibliografitë; aftësimin për të njohur shërbimet që biblioteka ofron; përdorimin e katalogëve për të gjetur literaturë shkollore dhe jashtëshkollore; njohjen e burimet online në plotësim të kërkesave të aspektit mësimor edukativ, sfida sot është si të promovohet Aftësimi në Media e Informacion dhe nga kush.

*Në situatën aktuale të pandemisë Covid-19, bibliotekave u ka rënë kambana për më shumë vëmendje në promovimin dhe zbatimin e Aftësimin në Media Informacion për përdoruesit. Përse?*

Tanimë dihet që, përballë zhvillimit të vullshëm teknologjik, burimeve të shumta informuese elektronike dhe digjitale në rritje, portaleve të larmishme etj., qytetarët kanë ngaherë nevojë të

ndihmohen/orientohen/aftësohen që të mund të jenë në gjendje të navigojnë, të kërkojnë, të lokalizojnë, të vlerësojnë në mënyrë kritike burimin e informacionit dhe ta përdorin atë në mënyrë efikase për nevojat e tyre.

Por, kriza COVID-19, periudha e karantinimit, kur puna, mësimi dhe studimi kryhej nga shtëpia, dëshmuar qartë, që, jo të gjithë ishin të aftësuar në përdorimin e platformave elektronike, mënyrave/mjeteve të komunikimit online, gjetjes së informacionit të saktë, filtrimit të burimeve online, duke bërë madje që disa prej tyre jo rrallë të bëheshin preh e informacione jo të sakta; p.sh. mbi trajtimin e sëmundjes COVID-19, në një kohë që informacioni i marrë online ishte i dëmshëm për shëndetin, që në vetvete përbënte një fake-news. Gjithashtu, si kurrë më parë, ata ndoqën kanalet mediatike, që të mund të ishin të informuar në kushtet e izolimit. Parë në këtë kontekst, kur Aftësimi në Media Informacion merr më shumë përparësi, shtrëngohemi: të rishikojmë kurrikulat mësimore; të zhvillojmë sa më shumë trajnime në distancë; të hartojmë projekte pilot për aftësimin e stafit bibliotekar, mësuesve, përdoruesve; të përgatisim udhëzues e tutorialëve në ndihmë të tyre, gjithnjë në përshtatje me kushtet e nevojat e reja të diktuar nga pandemia COVID-19.

Por, vetëm kjo nuk mjafton. Ndonëse bibliotekat luajnë rolin e ndërmjetësit kryesor mes përdoruesit dhe informacionit, ku disa karakterizohen nga *mbidozë* informacioni, ndërkohë që ka të tjerë që sapo kanë nisur të hedhin hapat e para në *autostradën* e informacionit, sot, ka lindur nevoja e përfshirjes aktive në këtë lëvizje edhe të aktorëve të tjerë, si: komunitetet vendore, akademike, mediatike, si dhe institucionet arsimore.

*Lind pyetja: Përse?*

Pasi, në rrafsh kombëtar koncepti ende nuk njihet në mënyrë eksplicite, në jetën e përditshme kuptohet, diskutohet, por nuk përdoret në masë, ndërkohë që koncepti i *të mësuarit gjatë gjithë jetës* njihet më shumë; termi përdoret në mënyrë korrekte kryesisht nga bibliotekarët, por jo nga të gjithë mësuesit; përdoret në mënyrë konfuze nga studentët. Nuk figuron si term në tekste shkollore, fjalorët e gjuhës shqipe, fjalorët terminologjike apo ata dygjuhësh të botuar në vend. Njohuritë bazë nuk jepen as në arsimin e mesëm dhe as atë të lartë. Arsimimi në sistemin shkollor përqendrohet në aftësim kompjuterik, aftësim në teknologji, por jo në aftësim në media e informacion.

Ndërkohë që, në arsimimin kombëtar bibliotekar, Aftësimi në Media dhe Informacion në Shqipëri është ndër më parësorët. Përkufizimi më i saktë jepet nga komuniteti i bibliotekarëve dhe specialistëve të informacionit dhe komunikimit; nuk njihet në mënyrë eksplicite nga komunitetet e tjera. Individidi vepron si “i aftësuar në media dhe informacion”, navigon/lundron/kërkon pa udhërrëfyes në “oqeanin e dijes”, duke e identifikuar, lokalizuar, vlerësuar, përdorur informacionin, duke krijuar mesazhe në *shumëllojshmërinë e mediave*, pa e njohur/ditur termin Edukim/Aftësim në Media dhe Informacion.

Komunitetit të bibliotekarëve u bie kambana sot për më shumë vëmendje ndaj Aftësimin në Media Informacionin të përdoruesve, sidomos ndaj armatës të gjeneratës së re. Në një kohë kur po rritet një “gjeneratë elektronike, kur gjithnjë e më shumë informacioni po shpërndahet/shkëmbehet me shpejtësi marramendëse në rrjete sociale apo profesionale edhe nëpërmjet botës “magjike” të celularëve me një të prekur të ekranit a shtypje të tastierës; kur vështirë të gjesh sot njerëz të papërfshirë në risitë e “revolucionit teknologjik”; kur krijimi i shoqërisë së Aftësuar në Media Informacion është i nevojshëm, përditësimi i vijueshëm

kompetencave të kërkimit është domosdoshmëri. Prandaj, mbeten agjentët kryesorë në sistemin e arsimimit, pasi ndonëse teknologjia sjell ndryshime, ajo nuk është vendimtarja.

Këtë e dëshmon edhe fakti që kur UNESCO-ja përpiloi 5 Ligjet e Edukimit/Aftësimin në Media dhe Informacion (2016), u frymëzua nga modeli i 5 Ligjeve të Bibliotekonomisë, që datojnë nga viti 1931 e riparë në 1998, të cilat na i sugjeron të gjithëve fort sot, ku parashtron që:

Çdo qytetar i botës është në vetvete një krijues i informacionit/dijeve që përcjell një mesazh të caktuar. Për këtë arsye, çdo qytetari duhet t'i sigurohet dhe t'i garantohet në mënyrë absolute e drejta për të pasur qasje në informacion/dije. Në këtë prizëm, informacioni, mjetet e komunikimit, teknologjia, media dhe bibliotekat, ashtu si edhe çdo ofrues tjetër i informacionit, janë të destinuara për përdorim në shërbim të angazhimit kritik qytetar dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Edukimi mbi median dhe informacionin është një proces dinamik që nuk përfitohet menjëherë, por arrihet në momentin që ky edukim mbulon qasjen, kontrollin e njohurive, përdorimin, prodhimin dhe komunikimin e përmbajtjes së informacionit dhe medias.

Ndonëse bibliotekat do të vijojnë të kenë rolin kryesor, si për promovimin, ashtu edhe zbatimin e Edukimit/Aftësimin në Media dhe Informacion, jo vetëm si një përgjigje ndaj kërkesave në rritje të përdoruesve, por edhe si një mision bibliotekar për të realizuar "Shoqërinë e Dijes" dhe "Qytetarëve të ditur", në kushtet e sotme, kërkohet më shumë vëmendje dhe bashkëpunim nga të gjithë për:

- promovimin e konceptit/termit, zhvillimin e programeve mësimore dhe implementimin e Edukimit në Media e Informacion në kurrikulat e niveleve të ndryshme të sistemit arsimor kombëtar, ku koncepti të promovohet që në moshë të re, duke filluar nga shkolla fillore e vijuar gjatë gjithë procesit arsimor;
- organizimin e fushatave sensibilizuese, sidomos me gjeneratën e re;
- organizimin e tryezave të rrumbullakëta të bibliotekave në bashkëpunimin me median për lirinë e qasjen në informacion dhe fenomenit "fake-news";
- hartimin e doracakëve/udhëzuesve;
- ndërmarrjen e projekteve pilot për grupmosha të ndryshme;
- përfshirjen më të gjerë në këtë proces dinamik të sistemit kombëtar bibliotekar në praktikat e përditshme;
- hartimin e një strategjie kombëtare për "Aftësimin në Media dhe Informacion", edhe me përfshirjen e forcave politike, kulturore dhe ekonomike në nivel kombëtar;

si rruga e vetme për të ndërtuar një shoqëri informacioni për të gjithë.



*Kjo rubrikë është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Europian. Përgjegjësia e vetme për përmbajtjen e këtij dokumenti është e Institutit Shqiptar të Medias dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se reflekton pozicionin e Bashkimit Europian.*



*The regional program "Media for Citizens – Citizens for the media: Strengthening the Capacity of NGOs for the Development of Media and Information Literacy in the Western Balkans" is implemented with the support of the European Union by partner organizations Mediacentar Sarajevo, Albanian Media Institute, Macedonian Institute for Media, Montenegrin Media Institute, Novi Sad School of Journalism, Peace Institute, SEENPM.*